Bazuar në ligjin nr. 8457, datë 11.02.1999 “Për informacionin e klasifikuar “Sekret Shtetëror””, i ndryshuar, kreu III, neni 13, pika b), në Vendimin e Këshillit të Ministrave, nr. 662, datë 15.11.2017 “Për miratimin e rregullores për deklasifikimin dhe zhvlerësimin e informacionit të klasifikuar “Sekret Shtetëror”, kreu II, neni 4, pika a), c), dhe në Udhëzimin nr. 99, datë 13.04.2018 “Për zbatimin e vendimit nr. 662. datë 15.11.2017 për deklasifikimin dhe zhvlerësimin e informacionit të klasifikuar “Sekret Shtetëror”, Komisioni i Deklasifikimit dhe Zhvlerësimit të Informacionit të Klasifikuar “Sekret Shtetëror”, në AIDSSH, i ngritur me Urdhër nr. 13, datë 03. 05. 2018 të Kryetarit të Autoritetit “Për krijimin e Komisionit të Deklasifikimit dhe Zhvlerësimit të Informacionit të Klasifikuar “Sekret Shtetëror””, i ndryshuar në AIDSSH”, ka bërë deklasifikimin e informacionit të klasifikuar “Sekret Shtetëror”, me vendimin 21, datë 12.08.2022 si më poshtë:

Fondi arkivor i ish-Sigurimit të Shtetit që administrohet nga AIDSSH

I. Deklasifikoi plotësisht informacionet e mëposhtme:

1. Dosje Personale nr. 5132 “Bujqësia” në ngarkim të K. Zh., me 21 (njëzet e një) fletë ndër të cilat 4 (katër) fletë janë të klasifikuara me nivelin e klasifikimit “Tepër Sekret” dhe 8 (tetë) fletë janë të klasifikuara me nivelin e klasifikimit “Sekret”. Dosja i përket Fondit Dega e Punëve të Brendshme Durrës.
2. Dosje Pune nr. 5132, “Bujqësia”, në ngarkim të K. Zh., me 43 (dyzet e tre) fletë ndër të cilat 4 (katër) fletë janë të klasifikuara me nivelin e klasifikimit “Sekret”. Dosja i përket Fondit Dega e Punëve të Brendshme Durrës.
3. Dosje Personale nr. 4152 “Shkollari” në ngarkim të P. M., me 23 (njëzet e tre) fletë ndër të cilat 2 (dy) fletë janë të klasifikuara me nivelin e klasifikimit “Tepër Sekret” dhe 16 (gjashtëmbëdhjetë) fletë janë të klasifikuara me nivelin e klasifikimit “Sekret”. Dosja i përket Fondit Ushtria.

4. Dosje Personale nr. 92 “Shkëndia” në ngarkim të P. Sh., me 48 (dyzet e tetë) fletë ndër të cilat 12 (dymbëdhjetë) fletë janë të klasifikuara me nivelin e klasifikimit “Tepër Sekret” dhe 12 (dymbëdhjetë) fletë janë të klasifikuara me nivelin e klasifikimit “Sekret”. Dosja i përket Fondit Dega e Punëve të Brendshme Mirditë.
5. Dosje Pune nr. 92 “Shkëndia” në ngarkim të P. Sh., me 12 (dymbëdhjetë) fletë ndër të cilat 2 (dy) fletë janë të klasifikuara me nivelin e klasifikimit “Tepër Sekret” dhe 3 (tre) fletë janë të klasifikuara me nivelin e klasifikimit “Sekret”. Dosja i përket Fondit Dega e Punëve të Brendshme Mirditë.
6. Dosje Personale nr. 1493 “Aparati” në ngarkim të L. P., me 113 (njëqind e trembëdhjetë) fletë ndër të cilat 6 (gjashtë) fletë janë të klasifikuara me nivelin e klasifikimit “Tepër Sekret” dhe 81 (tetëdhjetë e një) fletë janë të klasifikuara me nivelin e klasifikimit “Sekret”. Dosja i përket Fondit Dega e Punëve të Brendshme Krujë.
7. Dosje Pune nr. 1493 “Aparati”, volumni i parë, në ngarkim të L. P., me 248 (dyqind e dyzet e tetë) fletë ndër të cilat 5 (pesë) fletë janë të klasifikuara me nivelin e klasifikimit “Tepër Sekret” dhe 15 (pesëmbëdhjetë) fletë janë të klasifikuara me nivelin e klasifikimit “Sekret”. Dosja i përket Fondit Dega e Punëve të Brendshme Krujë.
8. Dosje Pune nr. 1493 “Aparati”, volumni i dytë, në ngarkim të L. P., me 190 (njëqind e nëntëdhjetë) fletë ndër të cilat 4 (katër) fletë janë të klasifikuara me nivelin e klasifikimit “Tepër Sekret” dhe 11 (njëmbëdhjetë) fletë janë të klasifikuara me nivelin e klasifikimit “Sekret”. Dosja i përket Fondit Dega e Punëve të Brendshme Krujë.
9. Dosje Personale nr. 1288 “Dragobia” në ngarkim të H. D., me 125 (njëqind e njëzet e pesë) fletë ndër të cilat 3 (tre) fletë janë të klasifikuara me nivelin e klasifikimit “Tepër Sekret” dhe 82 (tetëdhjetë e dy) fletë janë të klasifikuara me nivelin e klasifikimit “Sekret”. Dosja i përket Fondit Dega e Punëve të Brendshme Krujë.
10. Dosje Personale nr. 821 “Karikja” në ngarkim të Gj. N., me 22 (njëzet e dy) fletë ndër të cilat 12 (dymbëdhjetë) fletë janë të klasifikuara me nivelin e klasifikimit “Tepër Sekret”. Dosja i përket Fondit Operativ.
11. Dosje Personale nr. 1391 “Shqiponja” në ngarkim të P. L., me 21 (njëzet e një) fletë ndër të cilat 4 (katër) fletë janë të klasifikuara me nivelin e klasifikimit “Tepër Sekret” dhe 16 (gjashtëmbëdhjetë) fletë janë të klasifikuara me nivelin e klasifikimit “Sekret”. Dosja i përket Fondit Dega e Punëve të Brendshme Krujë.
12. Dosje Pune nr. 1391 “Shqiponja” në ngarkim të P. L., me 25 (njëzet e pesë) fletë ndër të cilat 1 (një) fletë është e klasifikuar me nivelin e klasifikimit “Tepër Sekret” dhe 2 (dy) fletë janë të klasifikuara me nivelin e klasifikimit “Sekret”. Dosja i përket Fondit Dega e Punëve të Brendshme Krujë.
13. Dosje Pune nr. 1967 “Adriatiku” në ngarkim të Gj. U., me 230 (dyqind e tridhjetë) fletë ndër të cilat 60 (gjashtëdhjetë) fletë janë të klasifikuara me nivelin e klasifikimit “Sekret”. Fondit Dega e Punëve të Brendshme Krujë.
14. Dosje Personale nr. 1219 “Kasaforta” në ngarkim të K. V., me 54 (pesëdhjetë e katër) fletë ndër të cilat 12 (dymbëdhjetë) fletë janë të klasifikuara me nivelin e klasifikimit “Tepër Sekret” dhe 21 (njëzet e një) fletë janë të klasifikuara me nivelin e klasifikimit “Sekret”. Dosja i përket Fondit Dega e Punëve të Brendshme Lezhë.
15. Dosje Pune nr. 1219 “Kasaforta” në ngarkim të K. V., me 84 (tetëdhjetë e katër) fletë ndër të cilat 10 (dhjetë) fletë janë të klasifikuara me nivelin e klasifikimit “Sekret”. Fondit Dega e Punëve të Brendshme Lezhë.
16. Dosje Personale nr. 1950 “Gjoksi i Sorkadhes” në ngarkim të M. Sh., me 67 (gjashtëdhjetë e shtatë) fletë ndër të cilat 15 (pesëmbëdhjetë) fletë janë të klasifikuara me nivelin e klasifikimit “Tepër Sekret” dhe 8 (tetë) fletë janë të klasifikuara me nivelin e klasifikimit “Sekret”. Dosja i përket Fondit Dega e Punëve të Brendshme Krujë.

17. Dosje Pune nr. 1950 "Gjoksi Sorkadhes" në ngarkim të M. Sh., me 126 (njëqind e njëzet e gjashtë) fletë ndër të cilat 1 (një) fletë është e klasifikuar me nivelin e klasifikimit "Tepër Sekret". Dosja i përket Fondit Dega e Punëve të Brendshme Krujë.
18. Dosje Pune nr. 1950/1 "Gjoksi Sorkadhes" në ngarkim të M. Sh., me 7 (shtatë) fletë ndër të cilat 1 (një) fletë është e klasifikuar me nivelin e klasifikimit "Tepër Sekret" dhe 1 (një) fletë është e klasifikuar me nivelin e klasifikimit "Sekret". Dosja i përket Fondit Dega e Punëve të Brendshme Krujë.
19. Dosje Personale nr. 1808 "Drini" në ngarkim të K.K., me 53 (pesëdhjetë e tre) fletë ndër të cilat 9 (nëntë) fletë janë të klasifikuara me nivelin e klasifikimit "Tepër Sekret" dhe 26 (njëzet e gjashtë) fletë janë të klasifikuara me nivelin e klasifikimit "Sekret". Dosja i përket Fondit Dega e Punëve të Brendshme Shkodër.
20. Dosje Pune nr. 1808 "Drini" në ngarkim të K.K., me 174 (njëqind e shtatëdhjetë e katër) fletë ndër të cilat 8 (tetë) fletë janë të klasifikuara me nivelin e klasifikimit "Sekret". Dosja i përket Fondit Dega e Punëve të Brendshme Shkodër.
21. Dosje Personale nr. 1523 "Bushit" në ngarkim të N. R., me 41 (dyzet e një) fletë ndër të cilat 13 (trembëdhjetë) fletë janë të klasifikuara me nivelin e klasifikimit "Tepër Sekret" dhe 12 (dymbëdhjetë) fletë janë të klasifikuara me nivelin e klasifikimit "Sekret". Dosja i përket Fondit Dega e Punëve të Brendshme Krujë.
22. Dosje Personale nr. 1309 "Plepi" në ngarkim të P. D., me 23 (njëzet e tre) fletë ndër të cilat 9 (nëntë) fletë janë të klasifikuara me nivelin e klasifikimit "Tepër Sekret" dhe 8 (tetë) fletë janë të klasifikuara me nivelin e klasifikimit "Sekret". Dosja i përket Fondit Dega e Punëve të Brendshme Krujë.
23. Dosje Personale nr. 27 "Ideollatri" në ngarkim të A. B., me 62 (gjashtëdhjetë e dy) fletë ndër të cilat 25 (njëzet e pesë) fletë janë të klasifikuara me nivelin e klasifikimit "Tepër Sekret". Dosja i përket Fondit Operativ.
24. Dosje Personale nr. 924 "Shqiponja" në ngarkim të M. D., me 133 (njëqind e tridhjetë e tre) fletë ndër të cilat 40 (dyzet) fletë janë të klasifikuara me nivelin e klasifikimit "Tepër Sekret" dhe 2 (dy) fletë janë të klasifikuara me nivelin e klasifikimit "Sekret". Dosja i përket Fondit Drejtoria e Punëve të Brendshme Tiranë.
25. Dosje Pune nr. 924, "Shqiponja", në ngarkim të M. D., me 154 (njëqind e pesëdhjetë e katër) fletë ndër të cilat 19 (nëntëmbëdhjetë) fletë është janë të klasifikuara me nivelin e klasifikimit "Tepër Sekret". Dosja i përket Fondit Drejtoria e Punëve të Brendshme Tiranë.
26. Dosje Personale nr. 4246 "Tornitori" në ngarkim të Xh. D., me 61 (gjashtëdhjetë e një) fletë ndër të cilat 6 (gjashtë) fletë janë të klasifikuara me nivelin e klasifikimit "Tepër Sekret" dhe 14 (katërmëdhjetë) fletë janë të klasifikuara me nivelin e klasifikimit "Sekret". Dosja i përket Fondit Drejtoria e Punëve të Brendshme Tiranë.
27. Dosje Pune nr. 4246 "Tornitori" në ngarkim të Xh. D., volumi 1, me 255 (dyqind e pesëdhjetë e pesë) fletë ndër të cilat 2 (dy) fletë janë të klasifikuara me nivelin e klasifikimit "Tepër Sekret". Dosja i përket Fondit Drejtoria e Punëve të Brendshme Tiranë.
28. Dosje Pune nr. 4246 "Tornitori" në ngarkim të Xh. D., volumi 2, me 55 (pesëdhjetë e pesë) fletë ndër të cilat 1 (një) fletë është e klasifikuar me nivelin e klasifikimit "Tepër Sekret" dhe 2 (dy) fletë janë të klasifikuara me nivelin e klasifikimit "Sekret". Dosja i përket Fondit Drejtoria e Punëve të Brendshme Tiranë.
29. Dosje Personale nr. 235 "Mali" në ngarkim të R. Z., me 124 (njëqind e njëzet e katër) fletë ndër të cilat 7 (shtatë) fletë janë të klasifikuara me nivelin e klasifikimit "Tepër Sekret" dhe 60 (gjashtëdhjetë) dokumente me 68 (gjashtëdhjetë e tetë) fletë janë të klasifikuara me nivelin e klasifikimit "Sekret". Dosja i përket Fondit Drejtoria e Punëve të Brendshme Tiranë.
30. Dosje Pune nr. 235 "Mali" në ngarkim të R. Z., me 162 (njëqind e gjashtëdhjetë e dy) + zarf me 67 fletë ndër të cilat 1 (një) fletë është e klasifikuar me nivelin e klasifikimit "Tepër Sekret" dhe 40 (dyzet) fletë janë të klasifikuara me nivelin e klasifikimit "Sekret". Dosja i përket Fondit Drejtoria e Punëve të Brendshme Tiranë.

31. Dosje Pune nr. 235 "Mali" në ngarkim të R. Z., me 280 (dyqind e tetëdhjetë) fletë ndër të cilat 2 (dy) fletë janë të klasifikuara me nivelin e klasifikimit "Tepër Sekret" dhe 5 (pesë) fletë janë të klasifikuara me nivelin e klasifikimit "Sekret". Dosja i përket Fondit Drejtoria e Punëve të Brendshme Tiranë.
32. Dosje Personale nr. 9812 "Shqipe" në ngarkim të A. H., me 30 (tridhjetë) fletë ndër të cilat 3 (tre) fletë janë të klasifikuara me nivelin e klasifikimit "Tepër Sekret" dhe 6 (gjashtë) fletë janë të klasifikuara me nivelin e klasifikimit "Sekret". Dosja i përket Fondit Drejtoria e Punëve të Brendshme Tiranë.
33. Dosje Pune nr. 9812 "Shqipe" në ngarkim të A. H., me 75 (shtatëdhjetë e pesë) fletë ndër të cilat 2 (dy) fletë janë të klasifikuara me nivelin e klasifikimit "Sekret". Fondit Drejtoria e Punëve të Brendshme Tiranë.
34. Dosje Formulare nr 2473 në ngarkim të R. B., me 143 (njëqind e dyzet e tre) fletë ndër të cilat 39 (tridhjetë e nëntë) fletë janë të klasifikuara me nivelin e klasifikimit "Tepër Sekret" dhe 49 (dyzet e nëntë) fletë janë të klasifikuara me nivelin e klasifikimit "Sekret". Dosja i përket Fondit Drejtoria e Punëve të Brendshme Tiranë.

KRYETARI I KDZH: Dr. Gentiana Sula

Vendim nr. 25 datë 26.09.2022 (i shkurtuar)

Bazuar në ligjin nr. 8457, datë 11.02.1999 "Për informacionin e klasifikuar "Sekret Shtetëror"", i ndryshuar, kreu III, neni 13, pika b), në Vendimin e Këshillit të Ministrave, nr. 662, datë 15.11.2017 "Për miratimin e rregullores për deklasifikimin dhe zhvlerësimin e informacionit të klasifikuar "Sekret Shtetëror", kreu II, neni 4, pika a), c), dhe në Udhëzimin nr. 99, datë 13.04.2018 "Për zbatimin e vendimit nr. 662. datë 15.11.2017 për deklasifikimin dhe zhvlerësimin e informacionit të klasifikuar "Sekret Shtetëror", Komisioni i Deklasifikimit dhe Zhvlerësimit të Informacionit të Klasifikuar "Sekret Shtetëror", në AIDSSH, i ngritur me Urdhër nr. 13, datë 03. 05. 2018 të Kryetarit të Autoritetit "Për krijimin e Komisionit të Deklasifikimit dhe Zhvlerësimit të Informacionit të Klasifikuar "Sekret Shtetëror"", i ndryshuar në AIDSSH", ka bërë deklasifikimin e informacionit të klasifikuar "Sekret Shtetëror", me vendimin nr. 22, datë 12.08.2022 si më poshtë:

Fondi arkivor i ish-Sigurimit të Shtetit që administrohet nga AIDSSH

I. Deklasifikoi plotësisht informacionet e mëposhtme:

1. Dosje nr. 79 "Informacione nga letra të kapura nga kontrolli postar" me 9 (nëntë) fletë ndër të cilat 4 (katër) dokumente me 8 (tetë) fletë janë të klasifikuara me nivelin e klasifikimit "Sekret". Dosja i përket Fondit Drejtoria e I e Sigurimit të Shtetit.
2. Dosje nr. 230 "Korrespondencë e degëve të punëve të brendshme në rrethe me degën V për vënie në kontroll postar për të dënuar" me 15 (pesëmbëdhjetë) fletë ndër të cilat 14 (katërmëdhjetë) fletë janë të klasifikuara me nivelin e klasifikimit "Sekret". Dosja i përket Fondit Drejtoria e I e Sigurimit të Shtetit.
3. Dosje nr. 157 "Korrespondencë e "përkohshme", letra të ndaluara" me 189 (njëqind e tetëdhjetë e nëntë) fletë ndër të cilat 189 (njëqind e tetëdhjetë e nëntë) fletë janë të klasifikuara me nivelin e klasifikimit "Sekret". Dosja i përket Fondit Drejtoria e I e Sigurimit të Shtetit.
4. Dosje nr. 215 "Korrespondencë e "përkohshme", verifikime të ndryshme të kontrollit postar" me 168 (njëqind e gjashtëdhjetë e tetë) fletë ndër të cilat 162 (njëqind e gjashtëdhjetë e dy) fletë janë të klasifikuara me nivelin e klasifikimit "Sekret". Dosja i përket Fondit Drejtoria e I e Sigurimit të Shtetit.
5. Dosje nr. 153 "Drejtimet kryesore të veprimtarisë armiqësore zhvilluar nëpërmjet kanalit postar" me 5 (pesë) fletë ndër të cilat 2 (dy) dokumente me 4 (katër) fletë janë të klasifikuara me nivelin e klasifikimit "Sekret". Dosja i përket Fondit Drejtoria e I e Sigurimit të Shtetit.

6. Dosje nr. 229 "Informacion i Drejtorisë I dërguar këshillit të ministrave" me 2 (dy) fletë ndër të cilat 1 (një) fletë është e klasifikuar me nivelin e klasifikimit "Sekret". Dosja i përket Fondit Drejtoria e I e Sigurimit të Shtetit.
7. Dosje nr. 87 "Informacion mbi veprimtarinë armiqësore të zhvilluar nëpërmjet kanalit postar" me 17 (shtatëmbëdhjetë) fletë ndër të cilat 16 (gjashtëmbëdhjetë) fletë janë të klasifikuara me nivelin e klasifikimit "Sekret". Dosja i përket Fondit Drejtoria e I e Sigurimit të Shtetit.
8. Dosje nr. 72 "Mbi koordinimin e veprimtarisë të zonës kufitare dhe komandantëve të pikave të postave kufitare" me 15 (pesëmbëdhjetë) fletë ndër të cilat 14 (katërmëdhjetë) fletë janë të klasifikuara me nivelin e klasifikimit "Sekret". Dosja i përket Fondit Drejtoria e I e Sigurimit të Shtetit.
9. Dosje nr. 124 "Analizë mbi veprimtarinë armiqësore që zhvillohet nëpërmjet kontrollit postar mbi përpunimin e vlerësimit e korrespondencës" me 47 (dyzet e shtatë) fletë ndër të cilat 47 (dyzet e shtatë) fletë janë të klasifikuara me nivelin e klasifikimit "Sekret". Dosja i përket Fondit Drejtoria e I e Sigurimit të Shtetit.
10. Dosje nr. 102/1 "Analizë mbi veprimtarinë armiqësore që zhvillohet kundër vendit tonë nëpërmjet kanalit postar" me 13 (trembëdhjetë) fletë ndër të cilat 12 (dymbëdhjetë) fletë janë të klasifikuara me nivelin e klasifikimit "Sekret". Dosja i përket Fondit Drejtoria e I e Sigurimit të Shtetit.
11. Dosje nr. 146 "Informacione mbi veprimtarinë armiqësore nëpërmjet kanalit postar" me 8 (tetë) fletë ndër të cilat 6 (gjashtë) fletë janë të klasifikuara me nivelin e klasifikimit "Sekret". Dosja i përket Fondit Drejtoria e I e Sigurimit të Shtetit.
12. Dosje nr. 114 "Regjistër i evidencës shifrarë dhe tabelave të bisedimit për Ministrinë e shëndetësisë, shifrës speciale dhe postat e policisë" me 20 (njëzet) fletë ndër të cilat 20 (njëzet) fletë janë të klasifikuara me nivelin e klasifikimit "Sekret". Dosja i përket Fondit Drejtoria e I e Sigurimit të Shtetit.
13. Dosje nr. 84 "Raport llogaridhënës para kolektivit të kontrollit postar" me 10 (dhjetë) fletë ndër të cilat 5 (pesë) fletë janë të klasifikuara me nivelin e klasifikimit "Sekret". Dosja i përket Fondit Drejtoria e I e Sigurimit të Shtetit.
14. Dosje nr. 93 "Raport llogaridhënës para kolektivit të kontrollit postar" me 15 (pesëmbëdhjetë) fletë ndër të cilat 13 (trembëdhjetë) fletë janë të klasifikuara me nivelin e klasifikimit "Sekret". Dosja i përket Fondit Drejtoria e I e Sigurimit të Shtetit.
15. Dosje nr. 165 "Korrespondencë e zhvilluar për kontrollin postar" me 253 (dyqind e pesëdhjetë e tre) fletë ndër të cilat 253 (dyqind e pesëdhjetë e tre) fletë janë të klasifikuara me nivelin e klasifikimit "Sekret". Dosja i përket Fondit Drejtoria e I e Sigurimit të Shtetit.
16. Dosje nr. 232 "Korrespondencë e zhvilluar për Teknikën Operative, inventarë" me 133 (njëqind e tri dhjetë e tre) fletë ndër të cilat 92 (nëntëdhjetë e dy) dokumente me 127 (njëqind e njëzet e shtatë) fletë janë të klasifikuara me nivelin e klasifikimit "Sekret". Dosja i përket Fondit Drejtoria e I e Sigurimit të Shtetit.
17. Dosje nr. 160 "Informacion i Degës V për agjitacion e propagandë armiqësore nëpërmjet kanalit postar" me 4 (katër) fletë ndër të cilat 1 (një) dokument me 3 (tre) fletë është i klasifikuar me nivelin e klasifikimit "Sekret". Dosja i përket Fondit Drejtoria e I e Sigurimit të Shtetit.
18. Dosje nr. 163 "Informacion i Drejtorisë së I për disa probleme që dalin për doganën nëpërmjet kanalit postar e telefonik" me 3 (tre) fletë ndër të cilat 1 (një) dokument me 2 (dy) fletë është i klasifikuar me nivelin e klasifikimit "Sekret". Dosja i përket Fondit Drejtoria e I e Sigurimit të Shtetit.
19. Dosje nr. 231 "Korrespondencë e sektorit të vizave, degës V dhe VII për probleme që i përkasin kontrollit postar" me 96 (nëntëdhjetë e gjashtë) fletë ndër të cilat 94 (nëntëdhjetë e katër) fletë janë të klasifikuara me nivelin e klasifikimit "Sekret". Dosja i përket Fondit Drejtoria e I e Sigurimit të Shtetit.
20. Dosje nr. 216 "Korrespondencë e thjeshtë për kontrollin postar" me 295 (dyqind e nëntëdhjetë e pesë) fletë ndër të cilat 291 (dyqind e nëntëdhjetë e një) fletë janë të klasifikuara me nivelin e klasifikimit "Sekret". Dosja i përket Fondit Drejtoria e I e Sigurimit të Shtetit.
21. Dosje nr. 156 "Informacione të vëna në kontroll postar dhe letra të ndaluara" me 98 (nëntëdhjetë e tetë) fletë ndër të cilat 98 (nëntëdhjetë e tetë) fletë janë të klasifikuara me nivelin e klasifikimit "Sekret". Dosja i përket Fondit Drejtoria e I e Sigurimit të Shtetit.

22. Dosje nr. 126 "Përgjithësim mbi disa aspekte të veprimtarisë armiqësore nëpërmjet kontrollit postar" me 14 (katërbëdhjetë) fletë ndër të cilat 1 (një) dokument me 13 (trembëdhjetë) fletë është i klasifikuar me nivelin e klasifikimit "Sekret". Dosja i përket Fondit Drejtoria e I e Sigurimit të Shtetit.
23. Dosje nr. 158 "Korrespondencë e përkohshme" me 80 (tetëdhjetë) fletë ndër të cilat 74 (shtatëdhjetë e katër) fletë janë të klasifikuara me nivelin e klasifikimit "Sekret". Dosja i përket Fondit Drejtoria e I e Sigurimit të Shtetit.
24. Dosje nr. 133 "Informacione mbi ngjarje të jashtëzakonshme, të meta e mungesa në reparte e ndër-marrje ushtarake" me 10 (dhjetë) fletë ndër të cilat 5 (pesë) dokumente me 9 (nëntë) fletë janë të klasifikuara me nivelin e klasifikimit "Sekret". Dosja i përket Fondit Drejtoria e I e Sigurimit të Shtetit.
25. Dosje nr. 132 "Buletine informative mujore mbi veprimtarinë armiqësore e keqbërëse në radhët e ushtrisë" me 89 (tetëdhjetë e nëntë) fletë ndër të cilat 12 (dymbëdhjetë) dokumente me 73 (shtatëdhjetë e tre) fletë janë të klasifikuara me nivelin e klasifikimit "Sekret". Dosja i përket Fondit Drejtoria e I e Sigurimit të Shtetit.
26. Dosje nr. 131 "Proces verbal i mbledhjes me komandat e Sigurimit të Ushtrisë për analizën e punës për zbatimin e detyrave të shtuara në vitin 1978" me 187 (njëqind e tetëdhjetë e shtatë) fletë ndër të cilat 5 (pesë) dokumente me 43 (dyzet e tre) fletë janë të klasifikuara me nivelin e klasifikimit "Sekret". Dosja i përket Fondit Drejtoria e I e Sigurimit të Shtetit.
27. Dosje Formulare nr. 3679 në ngarkim të Sh. M. me 183 (njëqind e tetëdhjetë e tre) fletë ndër të cilat 28 (njëzet e tetë) fletë janë të klasifikuara me nivelin e klasifikimit "Tepër Sekret" dhe 38 (tridhjetë e tetë) fletë janë të klasifikuara me nivelin e klasifikimit "Sekret" Dosja i përket Fondit Operativ.

KRYETARI I KDZH: Dr. Gentiana Sula

Vendim nr. 26, datë 13.10.2022 (i shkurtuar)

Bazuar në ligjin nr. 8457, datë 11.02.1999 "Për informacionin e klasifikuar "Sekret Shtetëror"", i ndryshuar, kreu III, neni 13, pika b), në Vendimin e Këshillit të Ministrave, nr. 662, datë 15.11.2017 "Për miratimin e rregullores për deklasifikimin dhe zhvlerësimin e informacionit të klasifikuar "sekret shtetëror", kreu II, neni 4, pika a), c), dhe në Udhëzimin nr. 99, datë 13.04.2018 "Për zbatimin e vendimit nr. 662, datë 15.11.2017 për deklasifikimin dhe zhvlerësimin e informacionit të klasifikuar "sekret shtetëror", Komisioni i Deklasifikimit dhe Zhvlerësimit të Informacionit të Klasifikuar "sekret shtetëror", në AIDSSH, i ngritur me Urdhër nr. 13, datë 03. 05. 2018 të Kryetarit të Autoritetit "Për krijimin e Komisionit të Deklasifikimit dhe Zhvlerësimit të Informacionit të Klasifikuar "sekret shtetëror"", i ndryshuar në AIDSSH", ka bërë deklasifikimin e informacionit të klasifikuar "Sekret shtetëror", me vendimin nr. 26, datë 13.10.2022si më poshtë:

Fondi arkivor i ish-Sigurimit të Shtetit që administrohet nga AIDSSH

I. Deklasifikoi plotësisht informacionet e mëposhtme:

1. Dosje agjenturale nr. 4640 "Maska e Vjetër", me 134 (njëqind e tridhjetë e katër) fletë ndër të cilat 2 (dy) fletë janë të klasifikuara me nivelin e klasifikimit "Tepër Sekret" dhe 18 (tetëmbëdhjetë) dokumente me 30 (tridhjetë) fletë janë të klasifikuara me nivelin e klasifikimit "Sekret". Dosja i përket Fondit Operativ.
2. Dosje formulare nr. 4096 në ngarkim të M. Xh., me 20 (njëzet) fletë ndër të cilat 5 (pesë) fletë janë të klasifikuara me nivelin e klasifikimit "Tepër Sekret" dhe 1 (një) fletë është e klasifikuar me nivelin e klasifikimit "Sekret". Dosja i përket Fondit Emigrantët Ekonomik.

3. Dosje formulare nr. 2189 në ngarkim të N. Sh., me 46 (dyzet e gjashtë) fletë ndër të cilat 4 (katër) fletë janë të klasifikuara me nivelin e klasifikimit “Tepër Sekret” dhe 9 (nëntë) fletë janë të klasifikuara me nivelin e klasifikimit “Sekret”. Dosja i përket Fondit Dega e Punëve të Brendshme Korçë.
4. Dosje Përpunimi nr. 2370 në ngarkim të Th. B., me 106 (njëqind e gjashtë) fletë ndër të cilat 4 (katër) fletë janë të klasifikuara me nivelin e klasifikimit “Tepër Sekret” dhe 49 (dyzet e nëntë) fletë janë të klasifikuara me nivelin e klasifikimit “Sekret”. Dokumentet në dosje datojnë në vitet 1972-1991. Dosja i përket Fondit Dega e Punëve të Brendshme Lushnje.
5. Dosje Fashikullore nr 2751 në ngarkim të N. Gj., me 5 (pesë) fletë ndër të cilat 2 (dy) fletë janë të klasifikuara me nivelin e klasifikimit “Tepër Sekret” dhe 1 (një) fletë është e klasifikuar me nivelin e klasifikimit “Sekret”.

Dosja i përket Fondit Emigrantët Ekonomik.

6. Dosje Personale nr. 2328 në ngarkim të I. F., me 15 (pesëmbëdhjetë) fletë ndër të cilat 1 (një) fletë është e klasifikuar me nivelin e klasifikimit “Tepër Sekret”. Dosja i përket Fondit Operativ.
7. Dosje Përpunimi nr. 1631 në ngarkim të S. Ç., me 62 (gjashtëdhjetë e dy) fletë ndër të cilat 55 (pesëdhjetë e pesë) fletë janë të klasifikuara me nivelin e klasifikimit “Sekret”. Dosja i përket Fondit Dega e Punëve të Brendshme Sarandë.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

KRYETARI I KDZH: Dr. Gentiana Sula



VEPRIMTARI

TË AUTORITETIT PËR INFORMIMIN
MBI DOKUMENTET E
ISH-SIGURIMIT TË SHTETIT PËR
PERIUDHËN SHTATOR–TETOR 2022

AUTORITETI PREZANTON PUNËN E TIJ DOKUMENTARE NË JAVËN E KULTURËS SUEDEZE NË SHKODËR



Më datë 13 shtator Autoriteti për Informimin mbi Dokumentet e ish-Sigurimit të Shtetit mori pjesë në një aktivitetet të organizuar nga Ambasada Suedeze, në kuadër të javës kulturore suedeze, në qytetin e Shkodrës. i cili kishte si qëllim prezantimin e partnerëve lokalë dhe qendrorë të mbështetur me fonde të Qeverisë Suedeze për realizimin e veprimtarisë së tyre.

Ambasadorja e Suedisë në Shqipëri, Znj. Elsa Håstad, Kryetari i Bashkisë Shkodër, z. Bardh Spahia, Prefektja e qytetit Shkodër znj. Majlinda Angoni dhe të ftuar të tjerë të ambasadës vizituan, mes të tjerash, edhe stendën e Autoritetit me botimet shkencore dhe buletinët periodikë, në të cilët përshkruhet veprimtaria e Autoritetit në vite, aktet zyrtare, aktivitetet në kuadër të kujtesës, etj.

Autoriteti ka marrë mbështetje financiare nga Agjencia Suedeze për Zhvillim Ndërkombëtar në Tiranë (SIDA) për rikonstruksionin e ndërtesës dhe sigurimin e shërbimeve TIK për krijimin e një arkivi modern, të integruar, që tashmë ndodhet në mjediset e Autoritetit, pranë Ministrisë së Mbrojtjes. Projekti është pjesë e marreveshjes mes Qeverisë Suedeze dhe Autoritetit, për infrastrukturë bashkëkohore e kushte moderne për ofrimin e shërbimeve qytetarëve dhe studiuesve.



VIZITË NË EKSPOZITËN E HAPUR “MOM, I DON’T WANT WAR!”

Më datë 16 shtator me ftesë të Ambasadores së Polonisë, Znj. Monika Zuchniak-Pazdan dhe Ambasadorit të Ukrainës në Shqipëri, Z. Volodymyr Shkurov, Kryetarja në detyrë, Znj. Gentiana Sula dhe stafi i Autoritetit, vizituan ekspozitën “Mom, I don’t want war!”

“Mami, nuk dua luftë», në të cilën ishin mbledhur dhe ekspozuar vizatime të fëmijëve ukrainas që përshkruajnë pushtimin e vazhdueshëm rus dhe vizatimet e fëmijëve polakë të pas Luftës së Dytë Botërore.

Skena lufte nga 16 qytete polake u ekspozuan sot në sheshin “Skënderbej”, për të treguar ngjashmërinë “tronditëse” midis fotografive aktuale dhe atyre historike.



AUTORITETI NË KOMISIONIN PËR ÇËSHTJET LIGJORE, ADMINISTRATËN PUBLIKE DHE TË DREJTAT E NJERIUT



Më datë 11 shtator në Komisionin për Çështjet Ligjore, Administratën Publike dhe të Drejtat e Njeriut, u miratua në parim projektligji “Për një ndryshim në ligjin nr. 45/2015 “Për të Drejtën e Informimit për dokumentat e Ish-Sigurimit të Shtetit të Republikës Popullore Socialiste të Shqipërisë”, propozuar nga Autoriteti për Informimin mbi Dokumentet e ish-Sigurimit të Shtetit.



PJESËMARRJE NË KONFERENCËN E ORGANIZUAR NGA PREZENCA E OSBE-SË NË SHQIPËRI

Autoriteti për Informimin mbi Dokumentet e ish-Sigurimit të Shtetit, si anëtar i Bordit Këshillimor për projektin “Ndërtimi i kapaciteteve dhe profesionistëve shqiptarë në fushën e drejtësisë tranzicionale” zbatuar nga Prezenca e OSBE-së në Shqipëri, është i ftuar herë pas here të marrë pjesë në konferencat e organizuara nga Prezenca në vende të ndryshme të Shqipërisë. Në Universitetin “Eqrem Çabej”, Gjirokastrë, në prezantimin e punimeve të Masterit Ndërdisciplinor në Drejtësinë Tranzitore në Shqipëri, në kuadrin social, ligjor dhe historik.

VIZITË STUDIMORE NË KROACI

Më 27 shtator Prezenca e OSBE-së në Shqipëri organizoi një vizitë studimore në Kroaci për përfaqësues të institucioneve kryesore në këtë fushë, si Prokuroria e Përgjithshme, Autoriteti për Informimin mbi Dokumentet e ish-Sigurimit të Shtetit, Instituti i Mjekësisë Ligjore dhe Policia Shkencore. Përvoja e gjerë e Kroacisë në hetimin dhe gjykimin e rasteve të zhdukjeve me forcë mund t’i ndihmojë autoritetet shqiptare në çuarjen përpara të punës për identifikimin dhe gjetjen e eshtrave të personave të zhdukur gjatë regjimit komunist.

Programi përfshinte një vizitë në Ministrinë për Çështjen e Veteranëve dhe në Institutin e Mjekësisë Ligjore dhe të Kriminalistikës të Kroacisë. Duke folur në takimin e organizuar në ministri, zëvendëskryeministri dhe ministri për Çështjet e Veteranëve, Tomo Medved, ofroi mbështetjen e pakursyer të institucionit të tij për autoritetet shqiptare në përpjekjet e tyre për të bërë progres në identifikimin dhe gjetjen e eshtrave të zhdukurve. Zyrtarë të kësaj ministrie e njohën delegacionin shqiptar me modelin kroat të kërkimit të personave të zhdukur, ndërsa përfaqësues të Ministrisë së Brendshme, Prokurorisë së Zagrebit dhe të Arkivave Shtetërore folën për rolin e tyre në procesin e kërkimit.




Vizita u shërbeu ekspertëve shqiptarë, përfshi atyre të Institutit të Mjekësisë Ligjore dhe të Policisë Shkencore, edhe për të krijuar lidhje me homologët kroatë për bashkëpunim të ardhshëm në çështjen e kërkimit të personave të zhdukur.

Vizita u financua nga Fondacioni Konrad Adenauer (KAS) dhe u organizua nga Prezenca e OSBE-së në Shqipëri, në bashkëpunim me Ministrinë për Çështjen e Veteranëve të Kroacisë, KAS-in dhe Komisionin Ndërkombëtar për Personat e Zhdukur

TAKIM I AUTORITETIT PËR INFORMIMIN MBI DOKUMENTET E ISH-SIGURIMIT TË SHQIPËRI ME SHOQATËN E ISH- TË PËRNDJEKURVE POLITIKË TË QYTETIT TË VLORËS

Më 11 tetor Autoriteti për Informimin mbi Dokumentet e ish-Sigurimit të Shtetit zhvilloi në qytetin e Vlorës një takim me shoqatën e Ish të Përndjekurve Politikë të qytetit.

Të pranishëm në këtë takim ishin Kryetarja në detyrë, Znj. Gentiana Sula dhe Anëtarët e Autoritetit, Z. Albert Nikolla, Z. Skënder Vrioni dhe Z. Gjergj Marku, Kryetari i Shoqatës së të Përndjekurve Politikë të Vlorës, Z. Alban Agaj, Kryetari i Shoqatës Antikomuniste Z. Et’hem Fejzollari, ish-të përndjekur politikë të zonës dhe pasardhës të tyre.



Hapja e dokumenteve në arkivat e Autoritetit, zbardhja e dëshmive lokale mbi vuajtjet e ish të dënuarve politikë, evidentimi dhe gjetja e të zhdukurve, kthimi në qendra të vizitueshme për të rinjtë e shkollave, të vendbanimeve të të internuarve dhe kampeve të ish-të dënuarve politikë, ishin temat ku u përqendrua biseda gjatë këtij takimi.

Ish-drejtuksi i të përndjekurve politikë Z. Avni Agaj, i cili ka vuajtur 24 vjet në internim vlerësoi punën e Autoritetit në drejtim të zbardhjes së historisë së dënimit dhe vuajtjeve të të përndjekurve politikë si dhe ofroi ndihmën që nëpërmjet dokumenteve dhe dëshmive gojore të ish-të dënuarve të pasurohet më tej narrativa për vuajtjet, internimet e padrejta, pushkatimet pa gjyq në të shkuarën komuniste.

Mjekja e njohur e Vlorës, Znj. Antonela Agaj, bija e një prej ish-të përndjekurve politikë, theksoi nevojën për njohjen me të shkuarën komuniste të të rinjve. Në lidhje me këtë Kryetarja e Autoritetit, Znj. Gentiana Sula, tha se me Ministrinë e Arsimit është nënshkruar

marrëveshje me qëllim futjen në tekstet e historisë të ngjarjeve që shoqëruan vendosjen e regjimit komunist në vend.

Gjatë takimit me të përndjekur politikë, Ladurim Mersini, familja e të cilit ka bërë 300 vite burg, u shpreh se është emergjente hapja e dosjeve për bashkëpunëtorët dhe verifikimi e pastërtisë së figurës së zyrtarve të lartë, në mënyrë që njerëzit që i shërbyen regjimit,urvejuan, hetuan dhe dënuan njerëz pa faj të mos riciklohen më në politikë.

Më pas ekipi i Autoritetit vizitoi ekspozitën e të vrarëve dhe të burgosurve në qytetin e Vlorës.

Sipas statistikave që disponon Shoqata e Ish- të Përndjekurve Politikë të zonës, janë internuar rreth 850 familje nga më të shquarat, firmëtarë të aktit të Pavarsisë, pjesëmarrës në luftën e 1920 etj. Të burgosur gjithsej 1348 persona. Nga këta, të pushkatuar 75 burra, 4 gra, vdekje të burg 18 persona.

AKTIVITET I PREZENCËS SË OSBE-SË NË SHQIPËRI ZHVILLUAR NË UNIVERSITETIN “LUIGJ GURAKUQI” NË SHKODËR

Prezenca e OSBE-së në Shqipëri organizoi një takim në Universitetin “Luigj Gurakuqi” mbi të kaluarën komuniste dhe Drejtësinë Tranzitore në qytetin e Shkodrës më 14 tetor.

Shefi i departamentit për të drejtat e njeriut i OSBE-së në Shqipëri z. Cailean Maclean në takim ndër të tjera tha se studimet e larta mbi të kaluarën komuniste kanë informacion të kufizuar, ndërsa u shpreh se qeveria duhet të luajë rolin e saj që brezat e rinj të jenë të ndërgjegjësuar dhe të informuar saktësisht mbi komunizmin. Ai tha se është sfidë e madhe përsa i përket studimeve akademike lidhur me të drejtat e njeriut gjatë të shkuarës komuniste, ndërsa hulumtimet akademike vazhdojnë të kryhen në Shqipëri mbi këtë temë, por studimi i metodave të tyre lë shumë vend për përmirësim. Në mënyrë që të thellohet më shumë kjo njohuri mbi drejtësinë tranzitore dhe për të angazhuar e përfshirë më shumë të rinjtë Prezenca e OSBE-së në Shqipëri ka mundur krijimin e një qendre të specializuar për drejtësinë tranzitore në Universitetin e Tiranës në një master shkencor dhe po bën këto takime për të shtrirë këtë mastër edhe në universite të tjera.

Ndërsa rektorja e Universitetit të Shkodrës tha se më shumë se kurrë Shqipëria ka nevojë të përballet me të kaluarën e saj.

Në këtë takim ishin prezent specialistë nga Autoriteti, të cilët ndjekin studimet në Master Shkencor për Drejtësi Tranzitore pranë Universitetit të Tiranës.

KONFERENCA E 12-TË NDËRKOMBËTARE “Gjenealogjia e memories: Historia dhe kujtesa në marrëdhëniet ndërkombëtare”

Në datat 26-28 tetor u zhvillua në Varshavë, Poloni Konferenca e 12-të ndërkombëtare “Gjenealogjia e memories: Historia dhe kujtesa në marrëdhëniet ndërkombëtare”, organizuar nga Rrjeti Evropian i Kujtesës dhe Solidaritetit.

Gjatë tri ditëve të konferencës u trajtuan tema të cilat lidhen me memorien në nivel ndërkombëtar, tipologjitë e ndryshme të saj, për dëshmitë gojore, përkufizimin e memories, aktorët dhe veprimet që duhen ndërmarrë, u trajtuan vendet e kujtesës, memoria politike, historia dhe marrëdhëniet ndërkombëtare etj. Temat u trajtuan nga ekspertë të fushës, të universiteteve e institucioneve të vendeve të ndryshme, me profesionalizëm.




Bashkëpunëtorë në këtë organizim ishin edhe: Qendra për Studime e Europës Lindore dhe Ndërkombëtare, Zois, Berlin; Qendra për Studimin e Paqes dhe Konfliktit, Seton Hall University; Kolegji European, Natolin; Shkolla e Oksfordit për Studime Ndërkombëtare dhe Lokale; Universiteti i Varshavës, Fakulteti i Sociologjisë.

Mes të tjerash, përfaqësuesit e Autoritetit biseduan me z. Rafal Rogulski, Drejtor i Rrjetit Evropian të Kujtesës dhe Solidaritetit, lidhur me anëtarësimin e Shqipërisë në Rrjetin Evropian i Kujtesës dhe Solidaritetit

AUTORITETI NË MEDIA

GENTIANA SULA ISHTE E FTUAR NË STUDIO E EMISIONIT: “OPINION”




Më datë 8 shtator 2022 Znj. Gentiana Sula ishte e ftuar në studion e emisionit: “Opinion” të televizionit Klan për t’iu përgjigjur pyetjeve që drejtuesi i emisionit z. Blendi Fevziu kishte përgatitur për të. Pyetjet ishin rreth ligjit, funksionimit dhe marrdhënies së Auttoritetit me qytetarët e studiuesit si dhe pengesat ligjore që ka hasur Auttoriteti gjatë zbatimit të ligjit nga komisionet Mezini, Bezhani.

Në linkun e mëposhtëm është intervista e plotë e Znj. Gentiana Sula për emisionin “Opinion”

<https://www.youtube.com/ëatch?v=o2xzgplWwVQ>

INTERVISTA E KRYETARES SË AUTORITETIT NË TOP CHANNEL NË BREAKING TOP NEWS



Më datë 9 shtator Znj. Gentiana Sula Kryetare e Autoritetit ishte e ftuar në Breaking Top Neës, Top Channel, ku ndër të tjera Kryetarja e Autoritetit Znj.Sula theksoi se Partitë Politike nuk sjellin listat për transparencë. Në linkun e mëposhtëm mund të ndiqni intervistën e plotë.

<https://top-channel.tv/.../gentiana-sula-zbulon-se.../> [Gentiana Sula Faqja Zyrtare](#)

KRONIKË E TOP CHANNEL NË AMBJENTET E AUTORITETIT



Më 18 tetor në ambjentet e Autoritetit ishin gazetarët e Top Channel të cilët zhvilluan një kronikë.

Tre dekada pas rënies së komunizmit, dosjet e policisë sekrete famëkeqe të Shqipërisë për të ashtëquajturit “armiq të shtetit” po zbulojnë ngadalë sekretet e tyre. Megjithatë, disa nga viktimat e diktatorit paranojak Enver Hoxha, dhe sigurimit të frikshëm të shtetit që kishte mbi 10,000 informatorë dhe ende ka shumë bashkëpunëtorë - nuk durojnë të shikojnë, thotë AFP.

“Duke parë dosjet, ti shikon, edhe krahasuar me vendet e tjera, se dhuna politike është ekstreme, dënimi kapital është shumë i përdorur. Janë afërsisht 5500 të dënuar në proçese tëasaj kohe me vdekje.” - Gentiana Sula, Kryetare e AIDSSH. [Top Channel](#) [AFP](#) Për t’u njohur me kronikën ndiqni linkun [#TopChannelNeës](#) [#Sigurimi](#)

INTERVISTË E KRYETARES NË DETYRË TË AUTORITETIT ME GAZETAREN ZNJ. FATMIRA NIKOLLA MBI NDRYSHIMET LIGJORE



Më datë 27 tetor në ambjentet e Autoritetit u zhvillua intervista ndërmjet Kryetares në detyrë Znj. Gentiana Sula dhe gazetares së Neës 24-tës znj. Fatmira Nikolli mbi ndryshimet ligjore që u miratuan në Parlament. Ndër të tjera në intervistën e saj znj. Gentiana Sula Në linkun e mëposhtëm mund të ndiqni kronikën e plotë.

<https://youtu.be/jXDo73legQY>

‘OPINION’ NË AIDSSH



Më datë 27 tetor u transmetua në televizionin Klan në emisionin: “Opinion” vizita që z. Blendi Fevziu zhvilloi në ambjentet e Autoriteti duke realizuar kronikën me titull: “Ku ruhen e si janë dosjet e sigurimit” Në linkun e mëposhtëm është kronika e plotë.

[Opinion – Ku ruhen dhe si janë dosjet e sigurimit! - YouTube](#)

NJOHJA NXIT STUDIMIN

NEXHMIE ZAIMI, GAZETARJA SHQIPTARE E MBETUR NË (DRITË) HIJET E KOHËS

Ajkana Toni

Ah moj Shqipëri, kur do të vijë dita që do më japësh leje të vijë e të të shoh dhe të shoh familjen teme. ju pëkëdhel në zemër e plot sentiment sa herë që me vini në mendje. Ndoshta një ditë do t'ëmë japin lejen të vij andej për vizitë”!

Këto fjalë Nexhmie Zaimi shkroi në letrën dërguar vëllait të saj në Tiranë në 29 Janar 1980. Një letër që nuk mbërriti kurrë në dorën e tij dhe që u zbulua për herë të parë në dokumentin “Fondi Emigrantët Ekonomikë”, Dosje nr. 2183, “Nexhmije Zajmi”, pjesë e arkivës së Autoritetit për Informim mbi Dokumente të ish-Sigurimit të Shtetit.

Historia e shtetases shqiptaro-amerikane, Nexhmie Zaimi, shkolluar në Amerikë (1930), e cila punoi si gazeta-re e CNN, shpallur non grata nga Qeveria Shqiptare (1986), është pjesë e studimit “Nexhmije Zaimi, gazeta shqipëtare e mbetur në dritë-hijet e kohës”, përgatitur për Konferencën Shkencore “Dritë Hije”, nga Ajkana Toni.

Nexhmie Zaimi lindi në Shqipëri në 14 maj, 1917 dhe vdiq në Amerikë në 18 Prill, 2003 në Amerikë. Ajo ka qënë presidente e Federatës Pan –Shqiptare Vatra. Ka intervistuar liderë të Egjiptit dhe Palestinës, si dhe ka shkruar artikuj për problemet e refugjatëve Palestinezë.

Ka publikuar librin autobiografik “Bija e Shqiponjës” (1938). Ajo ishte një zë shumë aktiv kundër regjimit komunist. Gjatë kohës së Luftës në Kosovë, kur ishte 80 vjeç, mori në kujdesin e saj tre fëmijë shqiptarë të Kosovës, të cilët kishit pësuar plagë gjatë luftës.

Në Nju-Jork Nexhmie Zaimi njihej si “Zonja e parë e Shqipërisë” ndërkohë që Italia (ku ajo kishte punuar për një kohë) i ka dhënë titullin “Kalorës Kommander i Kurorës së Italisë” .

Ju ftojme të lexoni më tej për fatin e saj!

https://issuu.com/aidssh/docs/kumtesa_mbi_nexhmie_zaimin_nga_ajkana_toni


PERSEKUTIMI INTELEKTUAL NË REGJIMIN KOMUNIST - RASTI TREBESHINA

Enxhi Beka

Cila ishte elita dhe ç’raport kishin ato me pushtetin e kohës? Sa mundet pushteti i dijes të “kërcënojë” pushtetin politik? Elitat gjithmonë janë parë si një faktor kontribues në përmirësimin e jetës politike dhe sociale të shoqërive. Zotërimi i një fuqie të tillë ngjallte frikë tek sistemi komunist, pasi shihej si kërcënim i pushtetit të tyre. Sistemi shihte tek kjo elitë rrezikun e frymës së liberalizmit dhe influencës që ato mund të përhapin në shoqëri. Kjo elitë ishte kundër drejtimit të vendit nga një klasë politike dhe një udhëheqës që drejtonte me dorë të fortë. Kjo elitë ishte kundra kultit të individit që prodhonte terror dhe kontrollonte jetët e individëve. Rrjedhimisht kjo elitë u konsiderua si klasë armike. Ata të cilët, u munduan të transmetojnë një kulturë ndryshe me anë të krijmtarisë së tyre u konsideruan disidentë.

Sipas, Vladimir Tismaneanu disidentët artikuluan mundësinë, dhe nevojën për ta rishpikur politikën, e pasuruan me vlera që shohin shumë më larg se caku i ngushtë ideologjik apo pragmatik. Për pasojë këta disidentë u bënë protagonist të një odiseje përndjekjesh dhe persekutimesh. Në ligjin e datës 15/12/1944 mbi sabotatorët e elitës dhe pushtetit popullor parashikoheshin dënime deri në 30 vjet burg, të përjetshëm dhe me vdekje. Shumë dënime me vdekje u dhanë kryesisht pa gjyq.

Ndër përfaqësuesit e disidencës dhe elitës intelektuale mbetet dhe Kasem Trebeshina. Një figurë e analizuar me të gjitha dritëhijet e tij. Referuar dokumenteve të Arkivit të Shtetit, fondi i Partisë së Punës apo dokumenteve të Ish-Sigurimit të Shtetit, pa harruar këtu dhe kritikën akademike. Kasem Trebeshina vjen si një figurë komplekse, intelektuale dhe kundërshtuese e regjimit. “Gjuetia e shtrigave” nuk la jashtë vëmendjes së saj figurën e këtij intelektual.



AUTORITETI PER INFORMIMIN MBI
DOKUMENTET E ISH-SIGURIMIT TE SHTETIT

Adresa: Njësia Administrative nr. 4
Rruga e Dibrës, garnizoni "Skënderbej", Tiranë